

FJALA E DEPUTETES MIRELA PITUSHI

E ENJTE 10 MARS 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

U bë kohë që debatojmë për përfitimet e kompleksit teknologjik të qarkut të Fierit, nga njëra anë, për manipulimet dhe përfitimet të bëra në mënyrë të padrejtë nga të ardhurat e qytetarëve, nga xhepat e të cilëve dalin dhe qarkullojnë këto fonde dhe miliona euro. Ajo çka më tërheq vëmendjen është fakti që në mes të të gjithë kësaj zallamahie akuzash nuk ka pasur qoftë edhe një fjalë pozitive në këtë sipërmarrje nga ana e opozitës, sepse, mbi të gjitha, bëhet fjalë për shëndetin e qytetarëve tanë. Këto vepra vetëm janë përbaltur, janë dyshuar dhe nëpërkëmbur si në shumë raste të veprave të tjera, që opozita i ka goditur dhe koha ua ka rritur vlerën. Në fjalën time do të përqendrohem te përfitimi i madh që i ka bërë komunitetit fierak investimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane në qarkun tonë. Jo shumë muaj më parë kemi qenë dëshmitarë të reve të tymit të djegieve të mbetjeve. Jam e bindur që kolegët tanë kanë udhëtuar në drejtim të Jugut, janë kthyer nga Jugu dhe asnjë çast nuk kanë ndaluar për t'u qetësuar në lokalet pranë zonës së landfillit të qytetit. Këta kolegë jo vetëm që nuk ndaluan një çast, por nuk kanë thënë asnjë fjalë për këtë situatë, ku të kërkonin me shpejtësi përfundimin e impiantit, që, për hir të së vërtetës, është në një punë për t'u admiruar nga stafi i Bashkisë së Fierit. Kryetari i saj, zoti Subashi, në çdo përballje ka qenë i pastër, ashtu është edhe për këtë investim.

Tashmë, pas ngjarjeve të ndodhura, është një dëshmi e qartë sa i nevojshëm është grumbullimi, përpunimi në mënyrë bashkëkohore pikërisht i mbetjeve të tilla. Për ditë me radhë qytetarët fierakë kanë qenë nën efektin negativ të lëndëve toksike, të çliruara nga djegia e tyre. Sot jo vetëm unë, por të gjithë qytetarët presin vënien në punë në kapacitet të plotë të këtij investimi, për t'i dhënë fund njëherë e mirë kësaj problematike, duke mos harruar edhe faktin tjetër që zona e Fierit, si naftëmbajtëse, përballet me situata të pakëndshme në ndotjen mjedisore. Për vite me radhë të udhëtoje drejt Fierit ishte sfiduese për shkak të erës së rëndë. Të hapje dritaret në mëngjes do të asfiksoheshe nga era e naftës dhe djegiet e tymrave, kurse sot është krejt ndryshe, do të kemi një fushë argëtimi dhe çlodhjeje për të gjitha grupmoshat; do të kemi edhe ambiente kënaqësie në këtë vepër shtesë pas impiantit. Plot 7 hektarë tokë është mbjellë me 5000 pemë, dhe pritet të jetë parku më i madh i qytetit tonë, falë punës së mirë të Bashkisë Fier për hartimin e planeve gjeneruese të ambienteve. Falë punës së tyre sot qyteti i Fierit ka marrë një pamje të admirueshme, duke filluar nga parku qendror i qytetit, që dikur ishte vend grumbullimi i plehrave të zonës përreth, me gërmadha e godina të shkatërruara dhe të zaptuara nga mbetje inerte dhe urbane.

Sot mbi këto gërmadha është projektuar parku qendror i qytetit. Godina, e cila dikur ka shërbyer si fabrikë mielli, e ndërtuar në vitet '30, sot është galeria e qytetit, një vepër arti, me një arkitekturë moderne. Fieri sot krenohet me qendrën madhështore urbanistike pranë lumit Gjanica e të tjera. Pra, të nderuar deputetë, Është e drejta e gjithkujt të dijë sesi është ndërtuar dhe si do të administrohet ky

impiant, ashtu sikurse nuk duhet harruar fakti që në një distancë fare të vogël nga landfilli jetojnë dhjetëra familje, të cilat kanë qenë të kërcënuara nga çlirimi i lëndëve toksike. Qytetarët u manipuluan në lidhje me ndërtimin e impiantit të ri, pse ta fsheh, dhe u ndjenë shumë skeptikë kur dëgjonin gjithandej që ata që do të banonin afër kompleksit teknologjik do të kishin pasoja nga ndotja. Kjo rriti ankthin te njerëzit, të cilët dolën në protesta derisa u arrit të finalizohet ndërtimi i këtij impianti.

Vlen të theksohet se ky impiant ka në përbërje të tij një landfill për mbetjet urbane, një landfill për mbetjet inerte, një impiant modern për trajtimin e ujërave të ndotura, një impianti modern për paraseleksionimin e mbetjeve për riciklim, si dhe të gjithë infrastrukturën mbështetëse. Pra, ky impiant do të jetë dhe do të mbetet një investim serioz, që do të shërbejë në mënyrë të përkryer për përfitimet ekonomike nga shitja e energjisë elektrike, nga lëndët e riciklueshme, por edhe do të shmangë atë problematikë dhjetërvjeçare, që ka shoqëruar jetën e qytetarëve të Fierit. Të gjithë presim kalimin e këtij impianti në administrim dhe pronësi të Bashkisë së Fierit, duke pohuar pa frikë që ky është një ndër investimet e duhura për të gjithë komunitetin.

Do të vijë një ditë kur hyrja e qytetit tonë nuk do të mbajë më era kalbëzim, por një aromë gjelbërimi për zonën përreth. Do të shpëtojë njëherë e mirë ndotja e ujërave nëntokësorë për çdo linjë uji qoftë i pijshëm, apo jo. Pikërisht për këto duhet të diskutojmë, si përfitime shtesë, dhe të jemi krenarë që do t'u lëmë brezave pasuri me vlera ekologjike. Në të mirë të komunitetit, duhet të lëmë të vazhdojë puna në këtë projekt gjigant, që do të rrisë cilësinë e ajrit. Thërrimet që bëhen rrugës unë mendoj t'ia lemë drejtësisë që të thotë fjalën e saj. Faleminderit!